

## MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË “AKADEMINË E SHKENCAVE”.

Raporti Përfundimtar i Auditimit i ushtruar në Akademinë e Shkencave me objekt “*Auditimin financiar*” për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2015 si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr. **13, dt. 20.02.2016**. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën Nr. 1130/5, datë 25.04.2016, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar z Muzafer Korkuti, Kryetar i Akademisë së Shkencave, ku janë rekomanduar dhe kërkuar zbatimi i masave të mëposhtme:

### A. OPINIONI I AUDITIMIT

#### ***Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes***

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

#### ***Si theksim i Çështjes:***

Në zërin “*Ndërtime dhe konstruksione*” të aktivitetit të bilancit, pasqyrohet objekti në përgjegjësi administrimi të Akademisë së Shkencave, mbi të cilin institucioni nuk ka Certifikatë Pronësie. Ndonëse, institucioni ka iniciuar procedurat përkatëse administrative në ZVRPP, Tiranë, çështja mbetet akoma për tu theksuar.

#### ***Çështje të tjera.***

1. Vlera e prezantuar në zërin “*Detyrime afatshkurtra*” të pasivitetit të bilancit nuk rakordon në çelje të periudhës ushtrimore për vlerën 242,470 lekë, pasi *detyrimi ndaj shtetit për tatimin e llogaritur mbi të ardhurat personale* është deklaruar më shumë se sa është realisht, për vlerën 238,640 lekë; *detyrimi ndaj shtetit për Sigurimet Shoqërore* është deklaruar më shumë se sa është realisht, për vlerën 4,859 lekë; *detyrimi për pagat e pa paguara punonjësve* është deklaruar më pak se sa është realisht, për vlerën 999 lekë.

Si rrjedhojë, në mbyllje të periudhës ushtrimore, nuk rakordon dhe vlera e prezantuar në zërin “*Të tjera operacione me shtetin*” në aktivitetin të bilancit, e cila përfaqëson, detyrimet buxhetore, të lindura por të pa likuiduara në fund të vitit dhe që parashikohet të likuidohen me fondet buxhetore të vitit të ardhshëm.

2. Akademia e Shkencave nuk ka kryer rregullimet kontabël të mbylljes së llogarisë “*Studime dhe kërkime*” me vlerë 532,559 lekë, e cila përfaqëson fondet e alokuara dhe të shpenzuara nga Buxheti i Shtetit në vitin 2005, në artikullin 230 “*Projekte*”, në kuadër të Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit.

### B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:

1. Nga auditimi u konstatua se, nga Akademia e Shkencave janë paguar “honorar” për veprat e botuara, apo për punën kërkimore shkencore, përkatësisht për vitin 2014 në shumën 13 milion lekë dhe për vitin 2015 në shumën 17 milion lekë. Pagesa është kryer në bazë të tarifave të miratuara me VKM nr. 120, datë 27.01.1997 “*Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të*

dokumentacionit shkollor”, por duke e indeksuar rast pas rasti me 50% të masës së shpërblimit.

Ky indeksim që arrin përafërsisht në shumën 4,3 milion lekë në vitin 2014 dhe 5.6 milion lekë në vitin 2015, është bërë me iniciativë të vetë institucionit, me miratim rast pas rasti të Titullarit, referuar një korrespondence të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve me INSTAT-in, në vitin 2010, por pa patur ndonjë ndryshim ligjor të tarifave dhe as ndonjë iniciativë ligjore për ndryshimin e tyre.

Akademia e Shkencave ka si prioritet kryesor botimin dhe promovimin e veprave me vlera të veçanta shkencore të akademikëve e studiuesve, brenda e jashtë vendit, si monografi, revista periodike dhe buletine shkencore, të cilat janë pjesë e produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor të institucionit e janë realizuar në vlera të konsiderueshme, si dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit në kuptimin e ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, por që aktualisht nuk ka një harmonizim të legjislacionit në drejtim të shpërblimit të autorëve të veprave (Trajtuar në faqe 30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Akademia e Shkencave të marrë masa që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të rishikojnë dhe përmirësojnë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në lidhje me shpërblimin e autorëve të veprave apo për punën kërkimore shkencore, duke synuar që krahas mbrojtjes sa më të plotë të të drejtave të autorit, të ketë një vlerësim sa më real të shpërblimit të studiuesve e akademikëve. Të realizohet harmonizimi dhe aktualizimi i VKM nr. 120, datë 27.01.1997 me kërkesat e ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.

#### **Brenda vitit 2016**

**2.** Nga auditimi i kryer për krijimin dhe përdorimin e të ardhurave për periudhën objekt auditimi rezultoi se, gjatë viteve 2014 dhe 2015, Akademia e Shkencave, ka krijuar **të ardhura nga veprimtari ekonomike dytësore në masën 2,061 mijë lekë**, si rezultat i shitjes së botimeve të librave për 1,726 mijë lekë dhe i dhënies me qira të ambienteve për 335 mijë lekë.

Në zbatim të VKM-së nr. 432, datë 28.06.2006, Akademia e Shkencave dhe Ministria e Financave kanë hartuar Udhëzimin e përbashkët nr. 1/1, datë 22.12.2006. Në këtë udhëzim është përcaktuar që të ardhurat nga veprimtari ekonomike dytësore derdhen 70% në Buxhetin e Shtetit dhe **30% do ti mbeten institucionit**. U konstatua që të ardhurat nga veprimtaria dytësore e Akademisë së Shkencave, për periudhën 2014-2015, janë derdhur totalisht në buxhetin e shtetit, për shkak të pamundësisë së përdorimit brenda vitit nga ana e Akademisë së Shkencave. (Trajtuar në faqe 31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Akademia e Shkencave të marrë masa që, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të rishikojnë dhe përmirësojnë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në lidhje me përdorimin e të ardhurave nga veprimtaritë ekonomike dytësore, në mënyrë që këto të ardhura, të përdoren tërësisht në favor të institucionit të Akademisë së Shkencave dhe pjesa e pa përdorur e tyre të mbartet në vitin pasardhës. Gjithashtu, përdorimi i tyre të bëhet në përputhje me rregullat dhe standardet e programit buxhetor dhe menaxhimit financiar publik.

#### **Menjëherë**

**3.** Nga auditimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, ushtruar në bazë të programit të auditimit nr. 1104/1, datë 30.09.2012, konstatohet se

Akademia e Shkencave ka zbatuar rekomandimin e lënë për llogaritjen dhe derdhjen e kontributit të sigurimit suplementar për punonjësit me titull "profesor", "drejtues kërkimesh", "profesorë të asociuar" dhe "mjeshtër kërkimesh", të cilët janë në rolet drejtuese në këtë institucion (Kryetar, N/Kryetar dhe Sekretar Shkencor), duke përlllogaritur dhe derdhur kontributin e sigurimit shoqëror suplementar në masën 4% të pagës bruto. Ndërkohë që ndryshimet në Ligjin nr.10139, datë 15.05.2009 "Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, qendrës së studimeve albanologjike, akademisë së shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë", dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 23, datë 09.12.2014 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", i ndryshuar, kërkon që të mbahet edhe 5% të pagës bruto mujore të titullit "Profesor". Pra, sipas këtyre përcaktimeve këta punonjës duhet të paguajnë në muaj kontribute të sigurimeve shoqërore suplementare në masën 9% të pagës bruto mujore, ose mbi kontributin maksimal të funksionarëve të lartë shtetërorë.

Edhe pse nga Akademia e Shkencave i është kërkuar zyrtarisht Institutit të Sigurimeve Shoqërore rishikimi i këtij ligji vetëm për këtë kategori, si dhe kanë paraqitur mendimin e kundërshtimit e tyre gjatë ndryshimit të tij në vitin 2015, në Komisionin Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, përsëri ende nuk është gjetur një zgjidhje në lidhje me masën e këtij kontributi (Trajtuar në faqe 33-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Akademia e Shkencave të insistojë në kërkesën e saj, që në bashkëpunim me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Ministrinë e Financave, të ndërmarrin iniciativën ligjore për të zgjidhur përfundimisht problematikën në përlllogaritjen e kontributit të sigurimit shoqëror suplementar për punonjësit drejtues të Akademisë së Shkencave.

**Në vijimësi**

### **C. MASA ORGANIZATIVE**

**1.** Nga auditimi për hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare për periudhën objekt auditimi u konstatua:

Akademia e Shkencave nuk ka kryer procedurën e rakordimit dhe të mbylljes së llogarisë referuar Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006, për zërin "*Studime dhe kërkime*" me vlerë **532,559 lekë**. Ky zë përfaqëson fondet e alokuara dhe të shpenzuara nga Buxheti i Shtetit në vitin 2005, në artikullin 230 – *Projekte*, në kuadër të Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit.

Vlera e prezantuar në zërin "*Detyrime afatshkurtra*" të pasivit të bilancit nuk rakordon në çelje të periudhës ushtrimore të vitit 2014 për vlerën **242,470 lekë**. Si rrjedhojë në mbyllje të periudhës ushtrimore, **nuk rakordon** edhe vlera e prezantuar në zërin "*Të tjera operacione me shtetin*" në aktiv të bilancit, e cila përfaqëson, detyrimet buxhetore, të lindura por të pa likuiduara në fund të vitit dhe që parashikohet të likuidohen me fondet buxhetore të vitit të ardhshëm dhe është kundërparti e zërave të mësipërm. (Trajtuar në faqe 31-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Akademia e Shkencave të marrë të gjitha masat për të gjetur origjinën e këtyre veprimeve dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të bëjë sistemimin e këtyre veprimeve në kontabilitetin e institucionit, referuar legjislacionit në fuqi.

**Menjëherë**

2. Nga auditimi rezultoi se me Urdhrin e Kryetarit të Akademisë, nr. 244 datë 28.12.2012 është krijuar Grupi për Menaxhimin Strategjik, drejtues i të cilit është Titullari i institucionit dhe anëtarë të tij janë anëtarët e Kryesisë, Sekretari Shkencor në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe Përgjegjëse e Sektorit të Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues. *Nga auditimi mbi funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik rezultoi që edhe pse është e dokumentuar ngritja e GMS-së, nuk dokumentohet mbledhja të paktën 4 herë në vit, në kundërshtim me nenin 27 të ligjit “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Manualin mbi zbatimin e MFK-së pika 4.2.9 “Grupi për menaxhimin strategjik”, ku thuhet: “...duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit, për çështjet që lidhen me MFK-në. Rekomandohet që njësia të vërë në dispozicion të Grupit për Menaxhimin Strategjik një zyrë sekretarie. Kjo nënkupton se, duhet të caktohen nëpunës kompetentë për të organizuar mbledhjet e Grupit, për të mbledhur dhe ofruar informacionin e kërkuar nga anëtarët e Grupit, si dhe për të mbajtur protokollin e mbledhjeve”.*

*Gjithashtu, nuk është dokumentuar asnjë vendim i GMS, në kundërshtim me Manualin për MFK, pika 4.2.9 “Grupi për menaxhimin strategjik”, ku thuhet: “Vendimet e Grupit duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe në përputhje me standardet etike të sektorit publik. Vendimet e Grupit duhet të pasqyrohen në dokumente dhe t’i vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë” (Trajtuar në faqe 32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Akademia e Shkencave të marrë masa për të dokumentuar mbledhjet e Grupit të Menaxhimit Strategjik, si dhe dokumentimin e vendimeve të tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Manualin mbi zbatimin e MFK-së, të ndryshuar.

**Menjëherë**

3. Nga auditimi i rastësishëm i dosjeve të personelit në Akademinë e Shkencave rezultoi se, *të gjitha dosjet e personelit nuk përmbanin dëshminë e penalitetit, dokumentacion ky i cili duhet të jetë bashkëlidhur me të gjitha dokumentacionet e tjera. Në disa dosje të punonjësve, të cilët trajtohen me Kodin e Punës nuk janë të rinovuar me dokumentacionin aktual, si dhe u konstatua se pjesa më e madhe e dokumentacionit në dosje nuk janë as origjinale dhe as fotokopje të noterizuara, duke mos plotësuar kërkesat e VKM nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, pika 3 dhe pika 4 e lidhjes 1.(Trajtuar në faqe 33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Akademia e Shkencave të marrë masa për të plotësuar dosjet e personelit me të gjithë dokumentet konform kërkesave të VKM nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

**Menjëherë**

4. Nga auditimi konstatohet se, nga Titullari i autoritetit kontraktor nuk është nxjerrë urdhri për ngritjen e komisionit për përlllogaritjen e fondit limit të kontratës “Për shtypshkrime libri e periodikë”, të zhvilluar në vitet 2014-2015, edhe pse kjo përlllogaritje është bërë nga Sektori i Financës në bashkëpunim me Sektorin e Botimeve, mbështetur dhe në vendimin e Këshillit të Botimeve, duke mos zbatuar kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu II “Rregullat e përgjithshme të prokurimit dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 57, datë

12.06.2014 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimet me vlerë më të madhe se 400,000 lekë pa TVSh dhe më të vogël se 400,000 lekë pa TVSh”.

Po kështu nuk është plotësuar kërkesa e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 57, datë 12.06.2014 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimeve me vlerë më të madhe se 400,000 lekë pa TVSh dhe më të vogël se 400,000 lekë pa TVSh” për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.

Nga institucioni, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve, janë kryer proceduar prokurimi elektronike dhe me procedurën e blerjeve deri në 100,000 lekë, konform dispozitave ligjore dhe nënligjore në fushën e prokurimeve, por që në dy raste është konstatuar copëzim i fondeve, në mos zbatim të kërkesave të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu II “Rregullat e përgjithshme të prokurimit”, neni 8 “Kufijtë monetarë” pika 4, ku përcaktohet: “Asnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP”. *(Trajtuar në faqe 33-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Akademia e Shkencave të marrë masa për ngritjen e komisioneve të hartimit të fondit limit dhe atë të marrjes në dorëzim të mallrave e shërbimeve, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fushën e prokurimeve.

Akademia e Shkencave, në të ardhmen të shmangë fenomenin e copëzimit të fondit limit, si dhe në çdo rast të prokurimit ti referohet kërkesave të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu II “Rregullat e përgjithshme të prokurimit”.

**Menjëherë**

**5.** Nga auditimi rezultoi se Akademia e Shkencave, të gjitha veprimet dhe faktet ekonomike i regjistron manualisht në ditar dhe në llogaritë e përkatëse. Këto libra apo ditarë nuk ruhen në formate elektronike nga institucioni, gjithashtu institucioni nuk përdor programet financiare për mbajtjen e kontabilitetit, duke mos gjeneruar në kohë reale të dhëna të cilat do të ndihmonin stafin menaxherial në vendimmarrje. *(Trajtuar në faqe 35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Akademia e Shkencave të marrë të gjitha masat që në të ardhmen të sigurojë një proces automatik dhe efektiv të regjistrimit dhe raportimit të shpalosjeve në pasqyrat financiare vjetore, duke përdorur programe financiare të mbajtjes së kontabilitetit, të cilat do të sigurojnë kontrole të sigurta, efiçente e efektive dhe i mundësojnë drejtuesit të institucionit marrjen e një garancie të besueshme që vendimet në lidhje me buxhetin, planifikimin etj, janë zbatuar siç duhet.

**Menjëherë**

*Shënim:* Auditimi u krye nga audituesit: Selime Bregu (përgjegjës grupi), Alketa Kalleshi dhe Eni Kabashi, Ermira Vojka më tej materiali u shqyrtua nga kryeaudituesi, drejtori i departamentit juridik dhe zbatimit të standardeve dhe drejtori i departamentit.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**